

Партнерство за
Отворена
Власт на
**Северна
Македонија**



RAPORTIM I PAVARUR:

Republika e Maqedonisë së Veriut

FUSHA PRIORITARE:

**Mjedisi jetësor dhe
ndryshimet klimatike**

RAPORT PËR IMPLEMENTIMIN:

tetor 2021 – 19 shtator 2022

Ivana Petkanovska, CeProSARD Shkup





Во пресрет на подготовката на петтиот Национален акциски план за Партнерство за отворена власт 2021-2023 година (НАП за ПОВ 2021-2023), се формираше Мрежа на граѓански организации за ПОВ со цел поорганизирано делување и влијание на граѓанските организации на неговото креирање, како и поттикнување и мониторинг на имплементацијата на постојниот и идните акциски планови.

Со цел обезбедена вклученост на граѓанските организации во поддршка и следење на имплементацијата на НАП за ПОВ 2021-2023, Мрежата за ПОВ учествува и придонесува за воспоставување структура за координација и мониторинг на развојот и спроведувањето на НАП за ПОВ 2021-2023 обезбедувајќи независен мониторинг на имплементацијата.

PËRMBAJTJA



Rezymeja përmbledhëse:

Republika e Maqedonisë së Veriut -

Mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike 5

I. Hyrja 8

II. Implementimi i planit aksional -

Mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike 10

III. Metodologjia dhe burimet 19

Aneksi I. 21

Pasqyra e implementimit të fushës prioritare -

Mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike 21

Aneksi II. 23

Burimet/materialet për verifikim 23

Ekzemplarin e këtij raporti e përpiloi Darko Antiq nga Shoqëria ESE në bazë të ekzemplarëve të raportit të MRP-së (mekanizmi për raportim të pavarur). Ekzemplari është përpiluar për përgatitje të raporteve, të cilat janë pjesë e procesit për vlerësim dhe monitorim të pavarur të Planit Aksional për PQH të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga përfaqësuesit e organizatave qytetare të cilat janë anëtare të Rrjetit Nacional të OQ-ve për PQH.



Association for emancipation,
Solidarity and equality
of women - ESE

REZYMEJA PËRMBLEDHËSE:

Republika e Maqedonisë së Veriut -
Mjedisi jetësor dhe
ndryshimet klimatike



Ky raport ofron një pasqyrë të implementimit të dy angazhimeve të PNA për PQH 2021 - 2023 nga fusha prioritare e Mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike. Qëllimi i përbashkët i këtyre angazhimeve është që nëpërmjet edukimit, ndërgjegjësimit të publikut dhe mundësimit të qasjes në të dhëna gjithëpërfshirëse dhe të besueshme, të kontribuojë në reduktimin e ndotjes së mjedisit jetësor dhe rrjedhimisht edhe të pasojave të ndryshimeve klimatike.

Situatat kontekstuale lokale që kanë ndikim negativ në PQH në vend, sipas kërkuesve, përfshijnë vazhdimësinë e pamjaftueshme në komunikim/transparencë/informim nga ana e institucioneve, veçanërisht duke vënë në dukje pasojat në vazhdimësi, të cilat ndodhin për shkak të ndryshimeve të shpeshta të stafit në institucion , gjë që i kthen proceset prapa. Gjithashtu spikatet varësia nga mbështetja e donatorëve për implementimin e masave për tejkalimin e sfidave ekologjike, në vend të planifikimit dhe menaxhimit më të mirë të mjeteve personale. Si një situatë kontekstuale globale që ka një ndikim të fortë negativ, veçohet kriza energjetike dhe ekonomike, e cila ngadalëson dhe ndërlikon proceset që lidhen me këtë fushë prioritare, ndërsa mundësitë për tejkalim dhe ndikim të pavarur dhe efikas të sfidave janë mjaft të kufizuara.

Duke parë një periudhë më të gjatë kohore, mund të thuhet se ka një përmirësim të situatave kontekstuale në vend, gjë që ndikon pozitivisht në PQH. Nuk bie në sy asnjë arritje e veçantë (përfshirë për shkak të natyrës së angazhimeve), por nuk pritet asnjë kthim prapa në periudhën e mbetur të implementimit. Aspekte premtuese: miratimi i rregullores së PBM-së pritët të sjellë shumë përmirësime, veçanërisht pasi është një proces i shumëpritur, shpallja e sistemit të subvencioneve dhe lidhja e zbatimit të rregullores me subvencione dhe sanksione. Pavarësisht rezultateve të planit aksional, Koalicioni Rural e konsideron PQH-në si një nga proceset më transparente. Natyrisht, ato përfshijnë angazhimet e shumta që shteti mori në rrugën e integritit në BE në kuadrin e kësaj fushe prioritare, si angazhimet në lidhje me ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit, nënshkrimin e deklaratës për Axhendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, si dhe ato të ndërmarra me anëtarësimin në Komunitetin e Energjisë.

PASQYRË E PËRGJITHSHME E FUSHËS PRIORITARE

Implementimi i përgjithshëm i angazhimeve nga fusha prioritare Mjedisi dhe ndryshimet klimatike është i mirë, ndërsa përfaqësuesit e shoqërisë civile janë mjaft aktivisht të përfshirë gjatë implementimit. Angazhimet nuk kanë potencial për t'u etiketuar si "të yjëzuara".

Megjithëse me implementimin e këtyre angazhimeve do të bëhet një hap i rëndësishëm përpara në fushën prioritare, megjithatë nuk mund të thuhet se në këtë fazë ato kanë çuar ose pritet të çojnë në rezultate "të mëdha" ose "të jashtëzakonshme" deri në fund të planit aksional. E themi këtë sepse këto janë angazhime që lidhen me implementimin e detyrimit ligjor të institucioneve dhe janë pjesë e një zinxhiri më të madh të aktiviteteve të nevojshme që duhen realizuar.

Si më e rëndësishme (nëse zbatohet) do të mund të veçohet arritja 5.2.5 Përpunimii një aplikacioni celular, i cili do të mundësojë qasje në të dhënat për nivelin e ndotjes së ajrit përmes telefonit celular dhe njoftime të vazhdueshme për qytetarët.

TABELA 1.

PASQYRË E SHPEJTË

Ky prioritet ekziston nga: në dy planet e para aksionale (2012 - 2014 dhe 2014 - 2016) termi "mjedisi jetësor" shfaqet pjesërisht, në një kontekst të ndryshëm dhe jo si një prioritet i pavarur. Në planin e radhës (2016 - 2018) si prioritet figuron vetëm termi "ndryshim klimatik", i cili vazhdon në planin 2018 - 2020. Edhe në planin e fundit aktual (2021 - 2023), prioriteti është me emrin e plotë. "Mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike".

Periudha e implementimit, që është lëndë e raportimit:
tetor 2021 - shtator 2022

Numri i angazhimeve në suazat e prioritetit: 2

ZHVILLIMI I PRIORITETIT

Niveli i hapjes dhe pjesëmarrjes: i hapur

Zëri i OQ-ve: ndikim i matur

Përfshirja e institucioneve publike: e kufizuar

IMPLEMENTIMI

Angazhime të miratuara: # 2 (1,15 %)

Angazhime të realizuara tërësisht: # 0 (0 %)

Niveli i bashkëpunimit ndërmjet OQ-ve dhe institucioneve publike: i kufizuar

PESË REKOMANDIME KRYESORE

Ato kanë për qëllim të informojnë zhvillimin e angazhimeve, të cilat janë pjesë e prioritetet që vlerësohet në planin e ardhshëm aksional dhe ta drejtojnë implementimin e planit aktual aksional. Monitorimi rekomandon si më poshtë:

Më shumë informata që në thirrjen për pjesëmarrje në PAN për mënyrën se si do të rrjedhë procesi dhe cilat janë pritshmëritë nga OQ-të dhe institucionet në atë proces, duke përfshirë një trajnim më të thelluar hyrës për OQ-të që do të prezantojnë të gjithë procesin e pjesëmarrjes në PQH .

Më shumë kohë për përpunimin e angazhimeve, për t'i lejuar ato të konceptohen më mirë dhe për të kontrolluar arritjet në mënyrë që të mos ketë mbivendosje në vetë angazhimin. Duhet të theksohet gjithashtu nëse angazhimet që tërhiqen gjatë procesit vërtet nuk duhej të rafinoreshin dhe të vazhdonin.

Për të përmirësuar dhe për t'i kushtuar më shumë vëmendje përcaktimit dhe përzgjedhjes së prioritetëve dhe masave – disa janë shumë të gjera, të tjera të kufizuara.

Konceptualizimi më i mirë i objektivave dhe treguesve për të qenë implementuese, si dhe formulimi i arritjeve.

Shkallëzimi më i detajuar në raport (p.sh. një shkallë me tri vlera në vend të pesë nuk jep një ide mjaft të qartë për ndryshimet/rezultatet që kanë ndodhur; formulimi "i kufizuar" për diçka që nuk është përfunduar plotësisht mund të japë përshtypja se diçka nuk është implementuar mirë, por kjo nuk do të thotë se është e keqe).

PËR AUTORIN

Mr.Ivana Petkanovska është inxhinierë e diplomuar, arkitekte dhe kontrolluese e autorizuar e energjisë. Nga viti 2008 punon në SHQ CeProSARD Shkup në tema nga fusha e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së mjedisit jetësor, efikasitetit energjetik, burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Që nga viti 2012, ajo është përgjegjëse për projekte në fushën e ndryshimeve klimatike dhe energjisë.



I. HYRJE

Partneriteti për Qeverisje të Hapur është një nismë globale që bashkon reformatorët e qeverisë dhe drejtuesit e shoqërisë civile në krijimin e planeve aksionale për t'i bërë qeveritëmëgjithëpërfshirëse, të përgjegjshme dhe llogaridhënëse. Angazhimet nga plani aksional në fushën prioritarë Mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike mund të bazohen në angazhimet ekzistuese, të identifikojnë hapa të rinj për zbatimin e reformave aktuale ose të iniciojnë veprime në një fushë krejtësisht të re. Monitoruesi i pavarur i angazhuar për të prodhuar këtë raport ka kryer një sërë aktivitetesh për të vlerësuar implementimin e angazhimeve për të siguruar që autoritetet të mbeten të përkushtuara për implementimin e tyre. Shoqëria civile dhe drejtuesit e qeverisë i përdorin këto vlerësime për të reflektuar mbi progresin e tyre dhe për të përcaktuar nëse veprimet e ndërmarra kanë ndikim në jetën e njerëzve.

Republika e Maqedonisë së Veriut merr pjesë në PQH që nga viti 2011 dhe deri më tani ka miratuar pesë plane aksionale. Planin e pestë aksional (2021 - 2023) tejkalon ambiciet e planeve të mëparshme, veçanërisht në aspektin e transparencës së prokurimit publik, ofrimit të shërbimeve publike dhe qajës në drejtësi për grupet e cenueshme. Implementimi i plotë i planit mund ta bëjë Republikën e Maqedonisë së Veriut lider rajonal në Ballkanin Perëndimor në fushat kryesore të qeverisjes së hapur dhe adreson prioritetet e procesit të anëtarësimit në BE.

Duke marrë parasysh shtrirjen dhe shkallën e planit të veprimit, nevojitet bashkëpunim i ngushtë ndërmjet institucioneve publike dhe shoqërisë civile për të arritur rezultate të rëndësishme. Angazhimet nga plani i pestë aksional i Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të organizuara në pesë fusha tematike: transparencë, antikorrupsion, ofrimi i shërbimeve publike, qasja në drejtësi dhe mjedisi jetësor dhe veprime klimatike. Angazhimet mbulojnë një sërë temash, duke përfshirë prokurimin publik, monitorimin e deklaratave të pasurisë së funksionarëve publikë, integrimin e prioriteteve qytetare në ofrimin e shërbimeve publike dhe përforcimin e qasjes në ndihmën juridike falas. Republika e Maqedonisë së Veriut po zbaton edhe planin e vet të dytë aksional për një parlament të hapur dhe planin e parë aksional për një gjyqësor të hapur për të përforcuar transparencën e autoriteteve gjyqësore.

Vlerësimin e ka bërë monitoruesja e pavarur Ivana Petkanovska nga SHQ CeProSARD Shkup, e cila ka bërë edhe këtë vlerësim. Raporti synon të informojë dialogun e vazhdueshëm për zhvillimin dhe implementimin e angazhimeve të ardhshme.

Ky raport përfshin implementimin e angazhimeve në fushën prioritarë Mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike nga plani i pestë aksional i Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2021 - 2023.

Sipas asaj që theksohet në Planin aksional nacional për PQH për 2021 - 2023, vendi ynë ka rezultate të njohura në procesin e qeverisjes së hapur, i cili ka nisur dhjetë vjet më parë. Këto rezultate theksohen edhe nga organizatat e shoqërisë civile që morën pjesë me angazhimin e tyre në këtë PAN të fundit, të pestë radhazi, në fushën prioritare të Mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike.

Në përputhje me praktikën e harmonizimit të angazhimeve nga plani aksional me synimet e Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, angazhimet nga kjo fushë prioritare janë të harmonizuara me qëllimin 13 - “Veprimi për Klimën”, Objektivi 13.3. - të përmirësohet edukimi, ndërgjegjësimi dhe kapacitetet njerëzore dhe institucionale për zbutjen e ndryshimeve klimatike, përshtatjen, reduktimin e ndikimit dhe paralajmërimin e hershëm. Në kuadër të këtij plani, fusha prioritare Mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike përmban dy angazhime: *Reduktimin e efekteve të ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor nga aktivitetet bujqësore dhe Qasjen në informatat për nivelin e ndotjes së ajrit.*





II. ZBATIMI I PLANIT AKSIONAL - MJEDISI JETËSOR DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

2.1. PASQYRË E PLANIT AKSIONAL - MJEDISI JETËSOR DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

Në krijimin dhe miratimin e angazhimeve në këtë fushë prioritare, janë përfshirë përfaqësues të shoqërisë civile dhe të institucioneve përkatëse për çdo angazhim individual, përkatësisht, për angazhimin 5.1. *Reduktimi i efekteve të ndryshimeve klimatike dhe mbrojtja e mjedisit jetësor nga aktivitetet bujqësore*, OQ Koalicioni rural si parashtues dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU) si institucion kompetent, ndërsa për angazhimin 5.2. *Qasje tek informatat për nivelet e ndotjes së ajrit*, Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj si parashtues dhe Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH) si institucion kompetent. Pjesëmarrësit e vlerësojnë procesin e zhvillimit si shumë të hapur dhe konsiderojnë se kanë pasur bashkëpunim të shkëlqyer gjatë krijimit të angazhimeve. Ndonëse nuk ka angazhime që nuk janë pranuar, megjithatë vërehet se gjatë procesit numri i angazhimeve të përfunduara deri në fund ka rënë. Pritet që t'i kushtohet më shumë vëmendje asaj nëse angazhimi duhet të ishte anuluar/tërhequr/pambaruar apo nëse duhet të inkurajohej përsosja dhe përfundimi i tij. Natyrisht, në rastet e justifikuara kur ka angazhime të ngjashme të paraqitura nga shumë organizata, ato bashkohen në një (kur është e nevojshme).

Për sa i përket nivelit të përgjithshëm të progresit në zbatimin e angazhimeve, një nga angazhimet e lartpërmendura - 5.2. *Qasja te informatat për nivelin e ndotjes së ajrit* mund të karakterizohet si një angazhim me implementim të konsiderueshëm, ndërkohë që për implementim të plotë në këtë fazë nuk mund të flitet. Gjithashtu nuk është e mundur të vlerësohet progres apo regres në krahasim me planin e mëparshëm, sepse nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë (të njëpasnjëshme) të angazhimeve në lidhje me problemin publik që trajtohet. Gjithsesi, duke u kthyer pas, mund të thuhet se në këtë fushë ka pasur progres të vazhdueshëm. Si një nga faktorët kryesorë që kontribuon në progresin pozitiv dhe suksesin në implementim dhe që mund të ndikohet janë bashkëpunimi, komunikimi dhe transparenca ndërmjet organizatave dhe institucioneve të shoqërisë civile, gjë që u theksua edhe nga të pranishmit. Faktorët që gjithashtu ndikojnë ndjeshëm, por që ishin më të vështirë për t'u parashikuar gjatë përgatitjes së planit dhe janë më të vështirë për t'u kapërcyer dhe/ose mbi të cilët pjesëmarrësit kanë ndikim të kufizuar, janë kriza globale energjetike dhe ekonomike..

Edhe pse nuk ka angazhime në këtë fushë prioritare që në këtë fazë të kenë çuar në ndryshime "të mëdha" apo "të jashtëzakonshme" për qeverisjen e hapur, megjithatë mund të thuhet se angazhimi 5.2. *Qasja te informatat për nivelin e ndotjes së ajrit* tregon rezultate shumë të mira, nivel të lartë bashkëpunimi mes pjesëmarrësve, komunikim, përkushtim, transparencë të përfaqësuesve të institucionit përgjegjës (MMJ).

2.2. ANGAZHIMET

I. (5.1.) Reduktimi i efekteve të ndryshimeve klimatike dhe mbrojtja e mjedisit jetësor nga aktivitetet bujqësore

RAPORTI I DIZAJNIT	RAPORTI I IMPLEMENTIMIT
1. Angazhimi zhvillohet nëpërmjet një procesi të hapur dhe konsultativ me pjesëmarrjen e palëve të prekura relevante: PO	1. Statusi i implementimit: i kufizuar
2. Angazhimi është i rëndësishëm për PQH: PO	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: JO

Qëllimi i përgjithshëm i angazhimit është që përmes rritjes së edukimit dhe ndërgjegjësimit të popullsisë rurale të zvogëlohet ndotja e mjedisit jetësor dhe të zvogëlohen efektet negative të ndryshimeve klimatike.

Angazhimi vë në dukje problemin publik lidhur me ndotjen e mjedisit jetësor dhe rritjen e efektit të ndryshimeve klimatike si pasojë e aktiviteteve bujqësore. Sipas OQ-së Koalicioni Rural - parashtrues i angazhimit, në zonat rurale nuk ka informacion apo vetëdije të mjaftueshme për problemin e lartpërmendur dhe tema kryesisht perceptohet globalisht. Popullsisë rurale i mungon edukimi për të njohur pasojat e ndryshimeve klimatike dhe ajo se si kontribuon individi në shkaktimin e ndryshimeve klimatike. Konsiderohet se edhe qytetarët nuk janë mjaftueshëm të përfshirë në proceset vendimmarrëse lidhur me veprimet klimatike. Kjo rezulton me probleme, si reduktimi i prodhimit të ushqimit vendor dhe të ardhurave, ndotja e ajrit, rrezikimi i shëndetit të njerëzve, efektet negative të ndryshimeve klimatike, zbatimi i praktikave tradicionale (jo ekologjike) tashmë të krijuara, si dhe moszbatimi i legjislacionit të miratuar dhe normat e miratuara.

Siç thekson OQ Koalicioni Rural në tekstin e angazhimit, „**bujqit menaxhojnë 50 % të tokës në RMV, përdorin 60 deri në 80% të ujit të ëmbël në vend, në stallat e tyre, kotecet, fushat ose, nëse shprehemi në gjuhë moderne ferma, jetojnë një numër i madh i kafshëve, shfrytëzojnë mijëra ton substanca toksike të forta dhe më pak të forta në formën e pesticideve, plehrave dhe agrokimikateve të tjera**”. Sipas hulumtimit për strukturën e ekonomive bujqësore, të kryer nga Enti i Statistikave në vitin 2016, në **sektorin individual janë angazhuar vetëm 5,2 % persona me çfarëdo shkollimi në bujqësi, ndërsa numri i personelit të punësuar me kualifikim të lartë në fushën e bujqësisë është vetëm 0,8 %**. Sa i përket ndërgjegjësimit të qytetarëve, nga 473 të anketuar nga 48 komuna në RMV në një anketë të realizuar nga MMJPH, mendimi më i zakonshëm është se ballafaqimi me ndryshimet klimatike nuk është detyrë e individit por e qeverisë, industrisë dhe kompanive dhe që qytetarët nuk e dinë dhe nuk kanë informacion të mjaftueshëm se si mund të ndihmojnë në përballimin e ndryshimeve klimatike.

Ky angazhim zotohet për përmirësimin e Rregullores ekzistuese, por më e rëndësishmja është vënia në funksion e saj, pra implementimi i saj në terren.

Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, angazhimi është zbatuar pjesërisht.

Kështu, në lidhje me arritjen e pikës 5.1.1. *Rritja e sasisë së informacionit në mesin e popullatës rurale për efektet negative të ndryshimeve klimatike dhe ndotjes së mjedisit jetësor* (tregues: numri i materialeve informative të përpunuara, numri i seminareve edukative të mbajtura në zonat rurale, numri i prodhuesve të informuar bujqësor) është realizuar numër i madh aktivitetesh promovuese nga OQ Koalicioni Rural, edhe atë:

- U mbajtën 3 punëtori praktike edukative për praktikën e zgjuara të klimës bujqësore drejtpërdrejt në terren me ndarjen e historive dhe praktikave të suksesit; gjithsej 61 pjesëmarrës ishin të pranishëm në trajnime ndërsa ishin planifikuar 45.
- U vizituan më shumë se 30 fshatra në 5 rajone të ndryshme planifikuese, u mbajtën 20 takime me bujq, u shpërndanë 250 fletushka dhe postera në bashkësitë lokale, u regjistrua një histori rajonale në Al Jazeera mbi ndryshimet klimatike në bujqësi, u zbatua një iniciativë lokale për edukimin e nxënësve për efektet e ndryshimeve klimatike.
- U hartuan 5 ekonomi bujqësore, të cilat aplikojnë masa për zbutjen e ndryshimeve klimatike në 5 rajone të ndryshme planifikuese (në 3 prej tyre do të mbahen leksione praktike në terren).

Për momentin nuk ka asnjë informacion të konfirmuar për zbatimin e aktiviteteve të ngjashme nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave. Për sa i përket afateve të parashikuara në plan, realizimi i arritjes është planifikuar deri në mars të vitit 2023.

Lidhur me arritjet e pritura 5.1.2. Rritja e volumit të informacionit tek popullsia rurale dhe edukimi për rregulloren e Praktikës së Mirë Bujqësore (PMB), si dhe ndryshimet në pjesën e sanksioneve për moszbatimin e saj në terren (numri i ekonomive bujqësore të vizituara, numri i materialeve informative të shpërndara, numri i sanksioneve të vendosura për moszbatimin e rregullores) konkluzioni është se:

→ Nuk ka të arritura, sepse për momentin nuk ka asnjë informacion zyrtar se deri ku është hartimi i Rregullores për PMB (ende nuk është hartuar).

Aktivitetet deri në momentin e përgatitjes së këtij raporti nuk kanë filluar ende, megjithëse fillimisht ishin planifikuar për periudhën tetor - dhjetor 2021.

Rreth arritjes së pritur 5.1.3. *Zgjerimi i listës së kushteve të veçanta minimale për PMB dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor që prodhuesit bujqësorë do të duhet të plotësojnë duke zbatuar Praktikën e mirë bujqësore dhe hartimin e një rregulloreje të re për praktikën e mirë bujqësore* (treguesit: numri i kriterëve të reja të përcaktuara në Rregulloren PMB, numri i modifikuar kushtet minimale ekzistuese të përcaktuara në rregullore, numri i ekonomive bujqësore të informuara për ndryshimet dhe rregullorja e re):

→ Arritjet nuk mund të veçohen për faktin se për momentin nuk ka asnjë informacion zyrtar për atë se në cilën fazë të përpunimit është Rregullorja e re e PMB, kështu që deri në miratimin e saj, mbledhja e të dhënave në lidhje me treguesit e treguar nuk është e zbatueshme.

Aktiviteti ende nuk ka filluar, megjithëse është planifikuar për në janar të vitit 2022, dhe realizimi sipas afatit kohor është planifikuar të përfundojë në mars të vitit 2023.

Angazhimi i OQ Koalicioni Rural – parashtues i angazhimit është mjaft domethënës, por i pamjaftueshëm për të folur për rezultate, sepse në fund rezultatet varen nga hartimi i Rregullores së re për PMB (përgjegjësi e MMJPH-së), përkatësisht pasojnë miratimin e saj. Prandaj, mund të thuhet se realizimi është ende i dobët, pra nuk mund të thuhet se ka rezultate që kontribuojnë në tejkalimin e problemit publik.

Angazhimi është i rëndësishëm për tre fusha të PQH.

Për transparencë, sepse duhet të lejojë qasje te informatat e reja dhe më shumë informata dhe cilësi dhe qasje më të mirë të informatave.

Për pjesëmarrjen civile, sepse duhet të përmirësojë mundësitë dhe kushtet për pjesëmarrjen e publikut dhe ndikimin në krijimin e vendimeve dhe mjedisin mundësues për OQ.

Për llogaridhënien publike, sepse duhet të përmirësojë rregullat, dispozitat dhe mekanizmat për llogaridhënien publike të funksionarëve.

Sipas OQ Koalicioni Rural, vitet e fundit është bërë shumë punë në këtë sektor dhe ka pasur përmirësime, veçanërisht në fushën e ndërgjegjësimit të bujqve për ndryshimet klimatike, dhe ata vetë tashmë po marrin intensivisht masa dhe teknologji moderne në bujqësi (ata janë fokusuar në kultura të tjera, investim në varietete, trajtime dhe mjete për të mbajtur lagështinë në tokë, sera, mbrojtje me rrjeta ndërtimi etj.), por komunikimi

i pamjaftueshëm dhe niveli i pakënaqshëm i transparencës të lënë përshtypjen se nuk po punohet, gjë që nuk korrespondon me gjendjen reale.

Për momentin nuk mund të thuhet se cilësia e informacionit apo sasia e informacionit, vlera e tij, kanalet e informacionit apo përgjigjet ndaj kërkesave për qasje në informacion janë përmirësuar, gjë që do të ndikonte në hapjen e autoriteteve.

Në periudhën e kaluar nuk janë krijuar mundësi të reja për të kërkuar informacione kthyesë apo për pjesëmarrje apo informim apo ndikim në vendime, kështu që nuk mund të komentohet për përfshirjen e mendimit të qytetarëve në vendime. Kanalet dhe hapësirat për të kërkuar informata kthyesë nuk janë përmirësuar - situata vlerësohet si status quo. Nuk ka asnjë informacion që kapacitetet e autoriteteve apo qytetarëve janë përmirësuar për të kërkuar informacione të lidhura me informatat kthyesë, duke mundësuar pjesëmarrjen, informimin apo ndikimin në vendime.

Kanalet, mundësitë dhe kapacitetet për të kërkuar llogari nga funksionarët nuk mund të thuhet se janë përmirësuar për momentin. Angazhimi mund të ndihmojë në krijimin e llogaridhënies në këtë fushë, domethënë do të kontribuonte në transparencë duke përmirësuar komunikimin. Nëse do të ishte e mundur, publiku do të mund të përdorte mekanizmat e llogaridhënies, në çdo rast është e nevojshme të informohet publiku në përputhje me rrethanat.



II. (5.2.) Qasja te informatat për nivelet e ndotjes së ajrit

RAPORTI I DIZAJNIT	RAPORTI I IMPLEMENTIMIT
1. Angazhimi zhvillohet nëpërmjet një procesi të hapur dhe konsultativ me pjesëmarrjen e palëve të prekura relevante: PO	1. Statusi i implementimit: i kufizuar
2. Angazhimi është i rëndësishëm për PQH: PO	2. Angazhimi ka sjellë ndryshime në sektorin publik: JO

Qëllimi i përgjithshëm i angazhimit është të sigurojë informacion të plotë dhe të besueshëm mbi nivelin e ndotjes së ajrit në RMV.

Angazhimi vë në dukje problemin publik me raportimin e pandërprerë të nivelit të ndotjes së ajrit në territorin e vendit. Konkretisht, megjithëse Rrjeti Shtetëror i Monitorimit për Cilësinë e Ajrit të Ambientit përmbush kriteret për numrin minimal të pikave matëse në një zonë dhe grumbullim të caktuar, të përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe direktivat evropiane për cilësinë e ajrit, rrjeti është përballur me probleme në vitet e kaluara në lidhje me funksionalitetin e vazhdueshëm të instrumenteve matëse, veçanërisht për shkak të vjetërsisë së pajisjeve. Kështu, instrumentet në lokacione të caktuara (si në Lisiçe dhe lokacione të tjera në Shkup, si dhe në Manastir) në vitet e kaluara kanë pasur ndërprerje të informacionit për nivelin e parametrave të caktuar për një periudhë të konsiderueshme kohore..

Siç thuhet në angazhimin e Shoqatës së Juristëve të Rinj të Maqedonisë, dhe në përputhje me të dhënat nga raportet mujore të sistemit shtetëror për monitorim automatik të cilësisë së ajrit të ambientit (https://air.moiepp.gov.mk/?page_id=290), *Instrumenti për monitorimin e përqendrimit të grimcave PM 10 nuk funksiononte në stacionin matës Lisiçe, ndërkohë që probleme me këtë instrument, si dhe instrumentet për monitorimin e përqendrimeve të grimcave të tjera (CO, NO2, O3, PM2.5 dhe SO2) janë vërejtur edhe në stacionet tjera matëse në Shkup. Gjithashtu, instrumentet për grimcat PM10 në stacionin matës Manastir 1 nuk kanë dhënë të dhëna për 187 ditë në vitin 2019, 26 ditë në vitin 2018, 79 ditë në vitin 2016 dhe 19 ditë në vitin 2015, ndërsa instrumentet për PM 10 në stacionin matës Manastir 2 nuk ka dhënë të dhëna për 192 ditë në vitin 2019, 56 ditë në 2018, 66 ditë në 2017, 6 ditë në 2016 dhe 56 ditë në 2015. Instrumentet për matjen e përqendrimit të grimcave PM 2.5 në stacionin matës Manastir 2, të cilat janë instaluar në vitin 2017, nuk kanë dhënë të dhëna për 192 ditë në vitin 2019 dhe 56 ditë në vitin 2018.*

Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, angazhimi është zbatuar pjesërisht.

Kështu, në lidhje me arritjen e pikës 5.2.1. *Vendosja e 4 stacioneve të reja matëse të cilësisë së ajrit si pjesë e rrjetit shtetëror të monitorimit (Prilep, Shtip, Ohër, Berovë) për të plotësuar vëllimin e informacionit për nivelin e ndotjes në këto katër qytete të publikuara në Portalin e Cilësisë së Ajrit (Air Quality Portal (moiepp.gov.mk)), dhe në drejtim të mundësimin të të më shumë informatave për qytetarët me qëllim të reagimit në kohë për marrjen e zgjidhjeve përkatëse (indiktorët: 1) numri i stacioneve matëse të reja të instaluar për matjen e cilësisë së ajrit, si pjesë e rrjetit shtetëror të monitorimit, 2) numri i informatave të publikuara në Air Quality Portal):*

→ Blidhur me treguesin e parë të numrit të stacioneve matëse të reja të instaluar, 2 stacione monitoruese janë instaluar në komunën e Berovës dhe në Prilep dhe janë vënë në funksion në fund të dhjetorit 2021, ndërsa instalimi i stacionit të tretë në Ohër pritej të përfundonte në fund të tetorit 2022. Caktimi i të katërtit është anuluar me ribalancimin e buxhetit për këtë vit.

→ Për sa i përket treguesit të dytë, në momentin e përgatitjes së raportit nuk janë dhënë të dhëna të sakta për numrin e informacionit të publikuar në Air Quality Portal.

Mund të thuhet se 50% e arritjes është realizuar dhe deri në tetor 2022 pritej realizimi i 25 % të tjerë. Kjo arritje nuk pritet të realizohet në tërësi brenda afatit të përcaktuar - 31.12.2022.

Për realizimin e arritjes së dytë - pika 5.2.2. - *Riparimi i instrumenteve për grimcat PM 10 dhe instalimi i instrumenteve të reja për PM 5 në ato stacione matëse që nuk janë në funksion për të shmangur ndërprerjen në informimin e publikut për nivelin e ndotjes në qytetet e tyre, janë treguar treguesit e mëposhtëm: 1) numri i instrumenteve të reja të instaluara për grimcat PM 2.5; 2) përqindja e territorit të vendit për të cilën merren të dhëna për grimcat PM10 dhe PM2.5.*

→ Lidhur me treguesin e parë, instrumentet për matjen e përqendrimeve të grimcave PM10 dhe PM2.5 janë instaluar në Prilep dhe Berovë në dhjetor 2021.

→ Për sa i përket përqindjes së territorit të vendit për të cilin merren të dhëna për grimcat PM 10 dhe PM 2.5, situata në gjysmën e parë të vitit 2022 sipas muajve është si më poshtë: janar 2022 - 94,02 %, shkurt 2022 - 94,51 %, mars 2022 - 92,53 %, prill 2022 - 91,95 %, maj 2022 - 89,77 %, qershor 2022 - 89,51 %.

Për momentin të gjitha instrumentet janë në funksion dhe kjo arritje është realizuar dukshëm. Afati i realizimit ishte paraparë deri në qershor të vitit 2022.

Treguesit e arritjeve 5.2.3. *Mirëmbajtja e rregullt e të gjitha stacioneve matëse për matjen e cilësisë së ajrit si pjesë e rrjetit shtetëror të monitorimit në vend për të shmangur ndërprerjen në informimin e publikut për nivelin e ndotjes në qytetet e tyre, janë si më poshtë: 1) numri i instrumenteve të ndryshuara; 2) numri i riparimeve të kryera dhe 3) numri i instrumenteve që kanë mbulim vjetor 90%.*

→ Në lidhje me treguesit e parë dhe të dytë të numrit të instrumenteve të ndryshuara/riparimeve të kryera, u dorëzuan të dhëna për 8 instrumente të reja që zëvendësuan instrumentet ekzistuese - të vjetruara në dhjetor 2021, si dhe për blerjen dhe dorëzimin e pjesëve rezervë në qershor 2022. Për çdo vit pasues të planit aksional, këto të dhëna do të plotësohen në përputhje me rrethanat.

→ Për sa i përket numrit të instrumenteve, të cilat kanë një mbulim vjetor prej 90 %, janë paraqitur të dhënat e shprehura në përqindje në qershor 2022: janar 2022 - 96,55 %, shkurt 2022 - 97,79 %, mars 2022 - 96,87 %, prill 2022 - 95,85 %, maj 2022 - 93,61 %, qershor 2022 - 91,01 %.

Kjo arritje është në proces të realizimit dhe data e përfundimit është planifikuar për në dhjetor 2023.

Arritja 5.2.4. *Sigurimi i një grupi instrumentesh matëse rezervë për të shmangur ndërprerjen në informimin e publikut për nivelin e ndotjes në qytetet e tyre nuk ka filluar.*

Afati i paraparë për realizimin e kësaj arritjeje (qershor 2022) nuk është respektuar për shkak të vonesës së fillimit të projektit të planifikuar nga ku duhet të blihen instrumentet matëse rezervë.

Lidhur me arritjen 5.2.5. *Përpunimi i i një aplikacioni celular që do të mundësojë qasje në të dhënat për nivelin e ndotjes së ajrit përmes telefonit celular dhe njoftime të vazhdueshme për qytetarët*, kjo nuk ka filluar. Për këtë aktivitet janë kërkuar mjete shtesë në kuadër të projekteve të realizuara nga MMJPH, por nuk janë miratuar dhe po kërkohen mjete nga donatorë të tjerë.

Afati i fundit i planifikuar për realizimin e kësaj arritjeje nuk do të respektohet për shkak të mjeteve shtesë të pasiguruara ende.

Statusi i arritjeve të lidhura me angazhimin 5.2. Qasja të informatat për nivelet e ndotjes së ajrit publikohet rregullisht në portalin Partneriteti për qeverisje të hapur: https://ovp.gov.mk/nar_proposals/пристап-до-информации-за-нивото-на-аер/.

Gjatë realizimit të këtij angazhimi është karakteristik niveli i lartë i bashkëpunimit ndërmjet përfaqësuesve të Shoqatës së Juristëve të Rinj të Maqedonisë, si parashtrues i angazhimit, dhe institucionit kompetent - Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor. Deri më tani, rezultatet më domethënëse të implementimit përfshijnë instalimin e dy (dhe fillimin e një të treti) stacioneve të reja matëse nga gjithsej katër të planifikuara. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se territori i vendit ka pasur një përqindje shumë të lartë të mbulimit të të dhënave për grimcat PM 10 dhe PM 2.5 në baza mujore në periudhën janar-qershor 2022, e cila lëvizte ndërmjet 89,51 - 94, 51 %. Pjesët e angazhimit që pritej të merrnin mbështetje financiare nga fondet dhe donacionet e jashtme/ndërkombëtare kanë një realizim më të dobët, pra në pjesën më të madhe të investimeve që nuk ishin planifikuar nga buxheti i shtetit. Faktor serioz është edhe ndikimi i krizës energjetike dhe ekonomike për shkak të të cilës janë reduktuar mjetet për investime pikërisht në lidhje me këtë angazhim, por edhe investimet nga buxheti janë faktor i rëndësishëm për nivelin e realizimit përfundimtar të angazhimit. Për momentin mund të thuhet se realizimi është i mirë dhe se deri në fund të ANA 2021 - 2023 mund të priten rezultate domethënëse që kontribuojnë në tejkalimin e problemit publik.

Sipas SHJRM-së, realizimi i këtij angazhimi kontribuon në procesin e hapjes së autoriteteve. Angazhimi është i rëndësishëm për tri vlera të PQH.

Për transparencën, sepse përmirësimi i rrjetit shtetëror të monitorimit për matjen e ndotjes së ajrit (përmirësimi, mirëmbajtja e rregullt dhe informimi) i mundëson publikut të marrë informacion të plotë dhe të besueshëm për situatën.

Për pjesëmarrjen e qytetarëve, sepse disponueshmëria e informacionit përkatës kontribuon në pjesëmarrjen më efektive të OQ-ve në politikat e ndotjes së ajrit, bazuar në argumente.

Për llogaridhënie publike, sepse duke ofruar informacion të besueshëm për nivelin e ndotjes së ajrit, qytetarët mund të monitorojnë arritjen e qëllimeve strategjike në fushën përkatëse dhe të reagojnë në përputhje me rrethanat, gjë që nxit përgjegjësinë e institucioneve për t'iu përgjigjur në kohën e duhur për zgjidhjen e sfidave dhe për të punuar në përputhje me detyrimet ligjore dhe ndërkombëtare të ndërmarrjes, si p.sh Konventa e Arhusit.

Mund të thuhet se angazhimi ka ndikuar në hapjen e autoriteteve, sepse është përmirësuar cilësia e informatave dhe numri i informatave relevante, vlera e tyre. Megjithatë, konsiderohet se duhet të punohet ende në përmirësimin e kanaleve të krijuara të informatave (faqe, rrjete sociale, media, etj.).

Nuk janë evidentuar disa mundësi të krijuara dhe të veçanta për të kërkuar informata kthyesë, për të mundësuar pjesëmarrjen, ndikimin në vendime, përfshirjen e opinionit të qytetarëve në vendime. Vlerësohet se nevojitet përmirësim i dukshëm i faqes së internetit dhe forcimi i komunikimit me e-mail me organizatat e shoqërisë civile në zonë. Megjithatë, profili i institucionit në Facebook spikat si një mjet që përdoret gjerësisht për informim, i cili në të njëjtën kohë ndikon në përmirësimin e kapaciteteve të qytetarëve për të kërkuar informata kthyesë, duke mundësuar pjesëmarrjen, informimin apo ndikimin në vendime.

Gjithashtu, nuk janë veçuar përmirësime të veçanta në lidhje me kanalet, mundësitë dhe kapacitetet për të kërkuar llogari nga funksionarët. Në të njëjtën kohë, paraqitet edhe pyetja për atë se sa janë të gatshëm qytetarët të përdorin mekanizma të tillë për të kërkuar llogari.





III. METODOLOGJIA DHE BURIMET

Ky raport është përgatitur për nevojat e projektit “Mbështetja e procesit të zbatimit dhe monitorimit të Planit Aksional Kombëtar për Partneritet për Qeverisje të Hapur 2021-2023, i cili zbatohet nga FSHHM së bashku me Qendrën për Komunikim Civil dhe Shoqatën për Emancipim, Solidariteti dhe Barazi të Grave - ESE, në bashkëpunim me Ministrinë e Shoqërisë Informatike, dhe mbështetet nga Sekretariati për Qeverisje të Hapur. Detyra kryesore e monitoruesit të pavarur është përgatitja e një raporti për ecurinë e implementimit të NAP-së për PQH 2021-2023 për fushën prioritare të Mjedisit Jetësor dhe Ndryshimeve Klimatike.

Gjatë përgatitjes së raportit, synimi kryesor u mor qëllimi kryesor i projektit - *lehtësimi i procesit të Partneritetit të Qeverisjes së Hapur (PQH) dhe monitorimi i Planit Aksional Kombëtar për 2021 - 2023 (ANA për PQH 2021 - 2023), si dhe synimet specifike të projektit: 1) sigurimi i implementimit në kohë dhe cilësor të ANA për PQH 2021 - 2023, 2) procesi i përforcuar për zbatimin e angazhimeve të ANA për PQH 2021 - 2023, 3) përmirësimi i cilësisë së përfshirjes së palëve të interesuara dhe dialogu i qëndrueshëm gjatë zbatimit i AKSH për PQH 2021 - 2023, 4) përfshirje e qëndrueshme dhe monitorim i përmirësuar gjatë zbatimit të angazhimeve të ANA për PQH 2021 - 2023 dhe 5) rritje e ndërgjegjësimit publik për arritjet në implementimin e ANA për PQH 2021 - 2023.*

Përpunimi përfshinte detyrat e mëposhtme specifike të punës:

- **pjesëmarrja në një seminar onlajn për zbatimin e metodologjisë së monitorimit me udhëzime të qarta për angazhimin dhe përgjegjësitë e punës;**
- **përgatitja e mjeteve të monitorimit;**
- **implementimi i metodologjisë, monitorimi, regjistrimi dhe raportimi i implementimit të ANA për PQH 2021 - 2023;**
- **pjesëmarrja në takime pune;**
- **përgatitja e raportit dhe dorëzimi.**

KORNIZA KOHORE:

DETYRA	KORIGJIMI
Pjesëmarrja në trajnime për zbatimin e metodologjisë së monitorimit	Shtator 2022
Implementimi i metodologjisë	3 shtator - 15 tetor 2022
Përgatitja e versionit të parë të raportit të monitorimit të implementuar	Deri 30 tetor 2022
Përgatitja e raportit përfundimtar	Deri 31 dhjetor 2022

Si bazë për informim të këtij raporti janë shfrytëzuar informata nga:

- Plani Aksional Kombëtar për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur 2021-2023 dhe më konkretisht angazhimet nga fusha prioritare *Mjedisi Jetësor dhe Ndryshimet Klimatike*
- Portali i partneritetit për qevqerisje të hapur (<https://ovp.gov.mk/>) si dhe pjesa specifike e dedikuar për monitorim të ANA të këtij portali për angazhimet nga fusha prioritare Mjedisi Jetësor dhe Ndryshimet Klimatike, https://ovp.gov.mk/nap_proposals/намалување-на-ефектите-од-климатскиот/ и https://ovp.gov.mk/nap_proposals/пристап-до-информации-за-нивито-на-аер/.
- Takime onlajn, komunikim me e-mail dhe dëshmi për verifikimin e arritjeve të paraqitura nga pjesëmarrësit në implementimin e dy angazhimeve, edhe atë për angazhimin 5.1. *Reduktimi i efekteve të ndryshimeve klimatike dhe mbrojtja e mjedisit jetësor nga aktivitetet bujqësore* - organizata civile Koalicioni Rural dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe angazhimi 5.2. *Qasja te informatat për nivelin e ndotjes së ajrit*, d.m.th. Shoqata Juristëve të Rinj të Maqedonisë dhe Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor.

Gjatë përgatitjes së raportit janë ndjekur udhëzimet e klientit, përfshirë materialet dhe udhëzimet e dhëna.

ANEKSI I.

PASQYRË E IMPLEMENTIMIT TË PRIORITETIT MJEDISI JETËSOR DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

Legjenda



E GJELBËR = i realizuar (i përfunduar)



E VERDHË = në vijim (vetëm nëse ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm dhe angazhimi do të realizohet)



E KUQE = angazhim i pafilluar ose i filluar, por nuk ka përparim në implementim

Numri (njëjtë si në PA)	Emri i angazhimit	Emri i aksioneve	Statusi i realizimit
5.1.	Reduktimi i efekteve të ndryshimeve klimatike dhe mbrojtja e mjedisit jetësor nga aktivitetet bujqësore	5.1.1. Rritja e vëllimit të informatave të popullsia rurale për efektet negative të ndryshimeve klimatike dhe ndotjes së mjedisit jetësor	
		5.1.2. Rritja e vëllimit të informatave të popullsia rurale dhe edukimi për Rregulloren e Praktikës së Mirë Bujqësore (PMB) si dhe ndryshimet në pjesën e sanksioneve për moszbatimin e saj në terren.	
		5.1.3. Zgjerimi i listës së kushteve minimale të veçanta për PMB dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, të cilat prodhuesit bujqësorë do të duhet të plotësojnë duke aplikuar PMB dhe hartimin e një rregulloreje të re për PMB	
5.2	Qasja të informatat për nivelet e ndotjes së ajrit	4 stacione të reja matëse të cilësisë së ajrit janë instaluar si pjesë e rrjetit shtetëror të monitorimit (Prilep, Shtip, Ohër, Berovë) për të plotësuar vëllimin e informatave për nivelin e ndotjes në këto katër qytete të publikuara në	

Број (исто како во АП)	Назив на залошбата	Назив на акциите	Статус на реализација
		Portalin e Cilësisë së Ajrit (Air Quality Portali (moepp.gov.mk)), dhe në drejtim të aktivizimit të më shumë informatave për qytetarët për hir të një reagimi në kohë për të ndërmarrë zgjidhjet përkatëse	
		Riparimi i instrumenteve për grimcat PM10 dhe instalimi i instrumenteve të reja për grimcat PM2.5 në ato stacione matëse që nuk janë në funksion për të shmangur ndërprerjen në informimin e publikut për nivelin e ndotjes në qytetet e tyre.	
		Mirëmbajtja e rregullt e të gjitha stacioneve matëse për matjen e cilësisë së ajrit si pjesë e rrjetit shtetëror të monitorimit në vend për të shmangur ndërprerjen në informimin e publikut për nivelin e ndotjes në qytetet e tyre.	
		Sigurimi i një grupi instrumentesh matëse rezervë për të shmangur ndërprerjen në ofrimin e informatave për publikun për nivelin e ndotjes në qytetet e tyre	
		Zhvillimi i një aplikacioni celular që do të mundësojë qasje në të dhëna për nivelin e ndotjes së ajrit përmes telefonit celular dhe njoftime të vazhdueshme për qytetarët	



ANEKSI II.

BURIMET / MATERIALET E VERIFIKIMIT

Burimet/materialet për verifikim i janë bashkangjitur raportit dhe përbëhen nga: foto të aktiviteteve të kryera, materiale promovuese në formatin PDF, si dhe një histori rajonale e regjistruar (të gjitha rreth angazhimit 5.1., stória gjendet në linkun e mëposhtëm: https://www.youtube.com/watch?v=_pMD_fxdjy0&t=49s), shënime nga takimet e punës ndërmjet implementuesve, informacione të publikuara në portalin PQH nga implementuesit (të gjitha për angazhimin 5.2.), komunikimet me email me të dhëna, si dhe regjistrime audio nga takimet e mbajtura online (për të dyja angazhimet - 5.1. dhe 5.2.).

MATERIALE TË DOBISHME

1. Microsoft Word - for web_2019-21-Design-Report-Template.docx (opengovpartnership.org)
2. Microsoft Word - for web_Implementation-Report-2017-19-APs-template_to-use-updated-12-17-19.docx (opengovpartnership.org)
3. IRM Reports and Analysis (opengovpartnership.org)
4. IRM Guidelines for the Assessment of Minimum Requirements (opengovpartnership.org)
5. NAP5-PARTNERSTVO-ZA-OTVORENA-VLAST-2021-2023-_-potvrden-od-Vlada-26.10.2021.pdf (ovp.gov.mk)



Procesi është mbështetur nga Sekretariati i PQH- së për nevojat e projektit "Mbështetje e procesit të zbatimit dhe ndjekjes së Planit nacional aksional për Partneritet për qeverisje të hapur 2021 - 2023", të cilin e zbaton Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedonia në partneritet me Qendrën për komunikime qytetare dhe Shoqatën për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave, në bashkëpunim me Ministrinë për Shoqëri Informatike dhe Administratë.